

Iu dha lamtumira e fundit veprimtares së arsimit, kulturës e politikës, Vahide Hoxha

Vahide Hoxha, simbol i guximit dhe i emancipimit

RRAHMAN PARLLAKU:

“Në radhët e Organizatës të Bashkuar të Veteranëve të Luftës, Vahideja, megjithë vështirësitë e moshës së thyer, ka qenë Kryetare tepër aktive dhe

e përkushtuar, që asnjëherë nuk i është shmangur vështirësive, por i ka shërbyer me nder ish luftëtarëve të lirisë dhe bashkëpunëtarëve të saj veteranë”.



Veterani

ORGANIZATA E BASHKUA E VETERANËVE TË LUFTËS ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE TË POPULLIT SHQIPTAR (OBVL)
GAZETË DYJAVORE. NR. 58 (289) 1-15 QERSHOR 2013. ÇMIMI: 20 LEKË

Kryeredaktor: Halil RAMA

Adresa: Ministria e Mbrojtjes, Tiranë.

Email: veterani.obvl@yahoo.com-al

NATO VLERËSON PROGRESIN NË KOSOVË DHE RAJON

Presidentja e Republikës, Atifete Jahjaga, priti më 29 maj delegacionin e nënkomisionit për Partneritet të Asamblesë Parlamentare të NATO-s, i cili po qëndron për vizitë në Kosovë për t'u njohur për së afërmi me aspektet politike dhe të sigurisë në Kosovë.

Delegacioni i Asamblesë Parlamentare të NATO-s vlerësoi progresin që Kosova dhe i gjithë rajoni kanë bërë drejt paqes dhe stabilitetit, duke garantuar mbështetjen e NATO-së ndaj FSK-së.

Presidentja Jahjaga, sipas zyrës së saj, i njohu parlamentarët e NATO-së me përparimin e Kosovës që nga shpallja e pavarësisë në konsolidimin institucional dhe ndërtimin e vizionit të përbashkët për një shtet të ndërtuar mbi parimin qytetar dhe të integruar në Bashkimin Evropian dhe në NATO.

Duke shprehur konsideratë për kontributin e NATO-s dhe forcës së saj paqeruajtëse KFOR në vendosjen dhe ruajtjen e paqes në Kosovë si dhe ndihmën e tyre për institucionet e vendit, Presidentja Jahjaga theksoi përkushtimin e Republikës së Kosovës për të ndërtuar marrëdhënie kontraktuale me Aleancën Veriatlantike dhe për ndërtimin e kapaciteteve të plota të Forcës së Sigurisë së Kosovës në bashkëpunim të ngushtë me aleatët ndërkombëtarë.

Presidentja Jahjaga theksoi se prania e NATO-s në Kosovë vazhdon të jetë garanci për sigurinë dhe stabilitetin e Kosovës dhe të rajonit. Ajo tha se Republika e Kosovës mbetet e përkushtuar në ndërtimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore me të gjitha vendet e rajonit dhe se marrëveshja e arritur nga kryeministrat e Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë në Bruksel, me ndërmjetësimin e BE-së dhe përkrahjen e SHBA-së, është përpjekje për të normalizuar marrëdhëniet në rajon. Ajo shprehu gatishmërinë e palës kosovare për implementimin e saj të plotë. Kryesuesja e delegacionit të NATO-s, Marit Nybakk, përshëndeti marrëveshjen e arritur në mes Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë, duke e vlerësuar atë si bazë drejt zhvillimeve të mëtejme pozitive në rajon.

Presidenca shpalli konkursin kombëtar edhe për ideimin e dekoratave dhe titujve të nderit

KONKURS KOMBËTAR PËR SIMBOLET E INSTITUCIONIT TË PRESIDENTIT



Faza e realizimit të objekteve: flamur, logo, dekorata dhe tituj nderi do të ndiqet nga një grup specialistësh dhe nga artisti fitues, me qëllim ruajtjen e cilësisë dhe saktësisë së imazheve fitues

Në mbrojtje të UÇK-së, kundër EULEX-it

Veteranët e luftës së UÇK-së, përveç për EULEX-in patën porosi edhe për ata që besojnë se e ndihmojnë këtë mision në ngritjen e akuzave. Smajl Elezaj, thotë se dëshmitarët kundër komandantëve po masin durimin e veteranëve, por se kësaj gjëje i ka ardhur fundi

FAQE 4

Çeta e Fterrës gjatë Operacionit Armik të Qershorit 1944

Fterra qëndroi gjatë kohës së Luftës NÇL në frontin e parë si një nga portat kryesore të Kurveleshit

FAQE 5

Menaxhim sa më i mirë i trafikut ajror të NATO

Anëtarësimi i Shqipërisë në NATO në vitin 2009, shënoi sfidën e parë të rëndësishme për Forcën Ajrore shqiptare dhe ANTA. Bashkëpunimi i shkëlqyer ndërmjet Forcës Ajrore dhe ANTA, me mbështetjen e fuqishme të komponentit ajror të NATO, në Izmir dhe SHAPE, sollën suksesin që ne përjetojmë sot, policimin ajror mbi qiellin shqiptar...

FAQE 7

HOMAZH

Ndërroi jetë Kryetarja e Shoqatës së Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Kosovës

LAMTUMIRË PROF. VAHIDE HOXHA



Prishtinë, 31 maj - Pas një sëmundje të shkurtër sot në Prishtinë ndërroi jetë prof. Vahide Hoxha, kryetare e Shoqatës së Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Kosovës, bashkëshorte e komandantit të Shtabit Kryesor të Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe Aradheve Partizane të Kosovës, Fadil Hoxhës.

E lindur më 26 qershor të vitit 1926 në Prizren, në një familje atdhetare arsimdashëse, Vahide Kabashi - Hoxha ishte një ndër vajzat e rralla shqiptare të Prizrenit që, në kohën e Jugosllavisë mbretërore, arriti ta kryente semimaturën në Gjimnazin e Prizrenit në gjuhën serbokroate. Pas kapitullimit të Jugosllavisë dhe bashkimit të Kosovës me Shqipërinë atëherë të okupuar nga Italia fashiste dhe çlirimit të vendit kreu gjimnazin në Shkodër e Prishtinë dhe Fakultetin Filozofik - Degën e Historisë në Shkup e Beograd. Pasi shërbeu një kohë si profesoreshë e historisë në Gjimnazin dhe Shkollën Normale të Prishtinës,

ishte edhe drejtoreshë e Muzeut dhe e Institutit të Historisë së Kosovës, kryetare e Bashkësisë së Kulturës së Kosovës, deputete dhe delegate në Kuvendin e Serbisë e të Jugosllavisë dhe anëtare e Këshillit Ekzekutiv (Qeverisë) së Kosovës.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, si shumë e re dhe gjimnaziste iu bashkua rinisë antifashiste dhe mori pjesë në demonstrata e aktivite të tjera antifashiste në Prizren dhe Prishtinë. Në nëntor të vitit 1944 merr pjesë në Konferencën Themeluese të Lidhjes së Rinisë Antifashiste të Kosovës në Gjakovë si anëtare e delegacionit të Rinisë antifashiste të Prizrenit. Ishte kryetare e Komitetit të Vendit e të Rrethit të Prizrenit e të Prishtinës, anëtare e Kryesisë së Frontit të Gruas Antifashiste të Kosovës dhe ushtri edhe funksione të tjera në jetën shoqërore, politike, kulturore e arsimore.

Gjatë rezistencës paqësore të popullit shqiptar të Kosovës kundër regjimit okupues serb në vitet '90 dhe

luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, krah për krah me bashkëshortin e vet, ishte në anën e popullit të vet lirisht duke mos u larguar për asnjë moment nga qyteti dhe pragu i vet.

Në qershor të vitit 2005 u zgjodh kryetare e Kryesisë së Shoqatës së Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Kosovës, të cilën e udhëhoqi me shumë përkushtim e sukses deri në momentet e fundit.

Mbledhja komemorativë për të ndjerën u mbajt të shtunën më 1 qershor 2013 në orën 11.00 në sallën e kinemasë ABC në Prishtinë. Kortezi funeral u nis nga shtëpia e së ndjerës në Prishtinë, rruga "Nazim Gafurri" nr. 145 në orën 13.00 kurse ceremoniali i varrimit u bë në orën 15.00 në varrezat e qytetit të Gjakovës pranë varrit të bashkëshortit të saj, Fadil Hoxhës.

**Kryesia e Shoqatës së Veteranëve të LANÇ të Kosovës
Vehap Shita e Pajazit Nushi,
nënkryetarë**

FJALË PERCJELLESE E KRYETARIT TË OBVL

Të nderuar familjarë të Zonjës Vahide,

Të nderuar bashkëluftëtarë e veteranë të luftës Antifashiste,

Të nderuar Zonja e zoterinjtë pjesëmarrës në këtë tubim mortor,

Më lejoni, që në emër të veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, dhe në emrin tim personal, tu përcjell ngushëllimet e mia të përzemërta, familjarëve të Zonjës Vahide, për humbjen e njeriut të tyre të dashur, dhe bashkëluftëtarëve të saj veteranë, për humbjen e kryetares së tyre të paharruar.

Personalisht, si pjesëmarrës i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, pata fatin të marr pjesë edhe në luftën për çlirimin e popullit vëlla të Kosovës, prandaj vazhdoj edhe sot, të ruaj të freskët në kujtesë, nderimin dhe respektin më të thellë, për partizanët trima të Kosovës, që luftuan heroikisht nën komandën e mikut tim të ngushtë, Zotit, Fadil Hoxha.

Fatmirësisht, me gjithë moshën e thyer, arrita ta shikoj të realizuar ëndrrën e time, ta shikoj Kosovën të lirë e të pavarur.

Kjo më dha mundësinë që, pas afër 50 vjetësh, të ritakohem me ish partizanët veteranë, dhe me mikun tim, zotin Fadil Hoxha,

Dhe, që prej asaj dite, lidhjet e dy Organizatave tona të Luftës, kanë vazhduar pambarimisht, bashkëpunimin e tyre. Aktivitetet tona dypalëshe, kanë vijuar me veprimtari

përkujtimore, në nderim të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, në nderim të ngjarjeve historike kombëtare, dhe në nderim të figurave të shquara të kombit tonë.

Bashkëpunimi ynë na njohu, me sukset dhe arritjet e Shqipërisë dhe të Kosovës.

Finalizimi i lidhjeve tona, ishte festimi i 100-vjetorit të pavarësisë, i cili na dha rastin, që të vendosim së bashku me zonjën Vahide Hoxha, në varrezat e të rënëve të kombit, pranë përmendores, Nënë Shqipëri, në Tiranë, kurorën në nderim të dëshmorëve.

Në radhët e Organizatës të Bashkuar të Veteranëve të Luftës, Vahideja, megjithë vështirësitë e moshës së thyer, ka qenë Kryetare tepër aktive dhe e përkushtuar, që asnjëherë nuk i është shmangur vështirësive, por i ka shërbyer me nder ish luftëtarëve të lirisë dhe bashkëpunëtarëve të saj veteranë.

Në emër të Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Luftës Nacionalçlirimtare, ju shprehim edhe një herë, familjarëve të Vahidesë dhe të gjithë të afërmit të saj, ngushëllimet tona më të sinqerta

I paharruar qoftë kujtimi i saj.

RRAHMAN PARLLAKU
*Kryetar i Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Luftës
Gjeneral-Lejtënant në Pension,
Hero i Popullit*

OBVL, telegram ngushëllimi familjes Hoxha dhe Shoqatës të Veteranëve të Luftës Nacionalçlirimtare të Kosovës

Përfaqësuese e vlerave më të shquara të patriotizmit shqiptar

Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Popullit Shqiptar (OBVL) i ka dërguar një telegram ngushëllimi Familjes Hoxha dhe Shoqatës të Veteranëve të Luftës Nacionalçlirimtare të Kosovës.

"E nderuara familje Hoxha,

Të nderuar bashkëluftëtarë të LANÇ, anëtarë të Shoqatës të Veteranëve të Luftës Nacionalçlirimtare të Kosovës!

Me hidhërim të thellë mësuam lajmin për ndarjen nga jeta të bashkëluftëtarës tonë, veteranes së Luftës Antifashiste, Vahide Hoxha. Vdekja e saj është humbje e madhe për

Familjen tuaj, për Shoqatën e Veteranëve të Luftës NÇI të Kosovës, për mbarë shoqërinë kosovare", -thuhet ndër të tjera në telegramin e OBVL. Kryesia e kësaj organizate vlerëson se Vahide Hoxha ishte dhe do të mbetet simbol i trimërisë, mençurisë dhe rezistencës kundër pushtuesve.

Ajo ishte përfaqësuese e vlerave më të shquara të patriotizmit shqiptar, vlera këto të demonstruara gjatë gjithë jetës së saj, si gjatë Luftës së Dytë Botërore, kur në moshë shumë e re dhe gjimnaziste iu bashkua rinisë antifashiste dhe mori pjesë në demonstrata e aktivite të tjera antifashiste në Prizren

dhe Prishtinë gjatë rezistencës paqësore të popullit shqiptar të Kosovës kundër regjimit okupues serb në vitet '90 dhe luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, krah për krah me bashkëshortin e vet, ishte në anën e popullit të vet lirisht duke mos u larguar për asnjë moment nga qyteti dhe pragu i vet", shprehen drejtuesit e OBVL në telegramin e ngushëllimit.

Në emër të OBVL ata shprehën ngushëllimet më të sinqerta, duke i garantuar se janë me familjarët e të ndjerës dhe me bashkëluftëtarët e tyre nga Kosova në këto momente të dhimbjes së madhe.

Jahjaga e Thaçi ngushëlluan familjen Hoxha

Presidentja e Republikës së Kosovës, Atifete Jahjaga dhe kryeministri Hashim Thaçi ngushëlluan familjen Hoxha, me rastin e vdekjes së veprimtares, Vahide Hoxha.

Në telegramin e Jahjagës thuhet: "Mora me pikëllim lajmin për vdekjen e Znj. Vahide Hoxha, veterane e Luftës Antifashiste, pedagoge dhe veprimtare e dalluar, vdekja e së cilës ka lënë zbrazëtitirë në familjen tuaj dhe në gjithë shoqërinë kosovare. Aktivitetet dhe angazhimet e zonjës Hoxha kanë lënë gjurmë të pashlyeshme në të gjitha fushat e punës së saj. Shpirtërisht dhe me lutje jemi me ju në këto çaste pikëllimi".

Ndërsa, edhe kryeministri i vendit, Hashim Thaçi ngushëlloi familjen Hoxha, me rastin e vdekjes së veprimtares Vahide Hoxha.

"Me pikëllim morëm lajmin për

ndarjen nga jeta të pedagoges, veprimtares dhe veteranes së Luftës Antifashiste, Vahide Hoxha. Vdekja e veteranes Hoxha është humbje për familjen tuaj dhe shoqërinë e Kosovës. Në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe në emrin tim, Ju shpreh ngushëllimet më të sinqerta", thuhet në telegramin e ngushëllimit.

Telegram ngushëllimi ka dërguar edhe zoti Ramush Haradinaj, kryetar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

Vahide Hoxha vdiq të premten e dates 31 maj 2013 në moshën 86 vjeçare. Ajo ishte kryetare e Shoqatës së Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe bashkëshorte e ish-udhëheqësit komunist, Fadil Hoxhës.

Iu dha lamtumira e fundit veprimtares së arsimit, kulturës e politikës, Vahide Hoxha

Simbol i guximit dhe i emancipimit

Gazmend Doli & Nora Shabani

Gjakovë, 1 qershor - Vahide Hoxha, kryetare e Shoqatës së Veteranëve të Luftës Antifashiste Çlirimtare të Kosovës, është varrosur të shtunën pasdite me nderime të larta në varrezat e qytetit të Gjakovës, në prani të qindra qytetarëve të Kosovës. Trupi i saj tash prehet pranë varrit të bashkëshortit të saj, Fadil Hoxha.

Shkrimtari Vehap Shita e ka përshkruar Vahide Hoxhën si një qytetare dinjitoze, si profesoreshë që më zërin e saj u ka mësuar historinë gjeneratave të shumta dhe si një nga vajzat e rralla të arsimuara të kohës.

"Ti po shkon sot për të pushuar në amshim pranë bashkëshortit tënd të nderuar... Por, kemi bindjen se pasardhësit tanë do të vazhdojnë rrugën tuaj të shtetndërtimit dhe Kosovës sonë martire e liridashëse", ka thënë ndër të tjera Shita.

Vahide Hoxha, përveç funksioneve të ndryshme ndër vite, prej 2005-s ka udhëhequr Shoqatën e Veteranëve të Luftës Antifashiste Çlirimtare të Kosovës.

Gjenerali në pension, Rrahman Parllaku, një bashkëluftëtar dhe mik me familjen Hoxha, ka ngushëlluar familjen në emër të veteranëve të LANÇ-së nga Shqipëria.

"Vahidja, me gjithë vështirësitë e moshës, ka qenë kryetare aktive dhe e përkushtuar që asnjëherë nuk u është shmangur sfidave, por i ka shërbyer me nder ish-luftëtarëve dhe bashkëpunëtorëve të saj", ka thënë Parllaku.

Ndërsa, kryetari i Komunës së Gjakovës, Pal Lekaj, tha se Vahide Hoxha ishte një shembull i rrallë i guximit në kohën kur më së shumti na duhej shkollimi.

"Ajo vazhdoi të bëhej shembull



për të mbrojtur kauzën tonë për çlirim dhe më vonë në një familje kombëtare të Gjakovës me bashkëshortin e saj, Fadil Hoxha, bëhen edhe shtyllë e mendimit dhe veprimit për të mbrojtur dinjitetin e këtij populli, e për të udhëhequr, e që ishte aq shumë i sfiduar. Figurat e Fadil e Vahide Hoxhës janë krenari e Gjakovës dhe e Kosovës", tha më pas Lekaj.

Publicisti Veton Surroi, i cili ka folur në emër të familjes së të ndjerës, ka bërë një përshkrim të personalitetit të Vahide Hoxhës dhe familjes së saj.

"Vahide Kabashi ka qenë syzezë, flokëkaçurrele, e kokëfortë", tha në fillim të fjalës së tij Surroi. "E ka një fotografi të tillë, është 16-vjeçare, mban në kokë një plis, ndërsa në duar një flamur shqiptar të kohës së okupacionit. Të gjitha, në atë fotografi janë të vërteta, edhe plisi, edhe flamuri, edhe sytë, edhe flokët kaçurrel, edhe kokëfortësia. Kjo e fundit shihet lehtë në nofullën e poshtme, është më e theksuar, është në ngjërç, është një sinjali i vendosmërisë, është një lloj sfidimi", ka thënë ndër të tjera Surroi, për tezen e tij, para qindra të pranishmëve të cilët po dëgjonin rrëfimin.

"Nofulla edhe kokëfortësia janë tipare identifikuese familjare të Vahide Kabashit", ka vazhduar më pas ai. "Babai i saj, çdonjëra prej motrave e vëllezërve, doli me këto tipare, çdonjëri prej tyre do të kishte bindjet, besimet e tyre, ndonjëherë edhe të kundërta në mes njëri-tjetrit, madje deri në antagonizëm", shtoi më pas Surroi.

Por, sipas tij, të përbashkëta kishin një bindje, një përkushtim, pothuajse një besim në kuptimin religjioz të fjalës.

"Ai ishte që populli shqiptar duhej emancipuar dhe se këtë duhet ta bënte duke sfiduar kohën dhe se koha sfidohej duke sfiduar të sotmen, sikur tek ajo, që duke shkruar në shkollë serbisht, pasi nuk kishte shkollë tjetër, edhe pse do të ishte ndër shqiptaret e rralla në ato banka shkollore", tha më pas Surroi.

Sipas publicistit Surroi, ajo fotografi do të dilte për 50 vjet në revista e gazeta nacionaliste serbe, si një lloj sfide bazike, si mund të jetojë ende e lirë, ajo syzeza, kaçurrelja, kokëforta.

"Liria e saj ka qenë e brendshme e ngulitur, e lindur, e ndoshta e gjen-

dur aty para lindjes. Ka qenë si ecja e saj e ngutshme edhe kur i kishte dhjetë, edhe pesëmbëdhjetë, edhe pesëdhjetë, edhe tetëdhjetë... Këmbët e saj merrnin turr kur ballafaqeshin me përpjetën", tha Surroi, në ceremoninë mortore të Vahide Hoxhës.

Për ish-bashkëshortin e liderit të LNC-së dhe funksionarit Fadil Hoxha, në këtë ceremoni është lexuar edhe një telegram ngushëllimi nga lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj.

Për Vahide Hoxhën, paradite në Prishtinë, të enjten është mbajtur një mbledhje komemorativë. Familjarë, miq, bashkëpunëtorë dhe të afërm kanë nderuar jetën dhe veprën e Vahide Hoxhës. Nënkryetari i Shoqatës së Veteranëve të LANÇ-së dhe bashkëpunëtori i ngushtë i së ndjerës, Pajazit Nushi, ka thënë se po i jep lamtumirën e fundit gruas së pikëllimit të kulturës së femrës në Kosovë. Ai ka thënë se biografia e Vahide Hoxhës pasqyron historinë e emancipimit të femrës shqiptare në Kosovë. Nushi ka numëruar ndryshimet administrative e shtetërore të Kosovës të cilat i ka jetuar e ndjera.

"Zhvillimi i saj prej kohës së Kosovës pjesë e Mbretërisë kroate-sll-ovene dhe serbe, Kosova pjesë e Mbretërisë shqiptare nën kurorën e perandorit italian Viktor Emanuelit të Tretë, Shqipëria e Kosova nën shtypjen e gjermanëve, Kosova në Luftën Nacionalçlirimtare, Kosova e Metohia, Kosova krahinë autonome, Kosova me status të barabartë me njësitë e tjera të Federatës jugosllave dhe Kosova shtet i pavarur", ka thënë Nushi. "Kjo është koha e ndryshimeve administrative dhe shtetërore e Kosovës, Kosova e 87-vjeçares dhe e aktivitetit arsimor, kulturor dhe politik të së ndjerës Vahide Hoxha", ka shtuar ai.

Ai ka thënë se pikëllimi për të nd-

jerën Vahide, është pikëllim i kulturës në të cilën e ka murosuar jetën e vet.

"Për ne ngel simbol i kuptimit femër, nënë, arsimtar dhe punëtoare politike e arsimit dhe e kulturës e denjë gjithmonë për nderim dhe respektim", ka thënë Nushi.

Ai ka përmendur vlerat e saj emancipuese, duke thënë se ajo nuk ishte model i emancipimit të femrës së një lagjeje, një qyteti apo krahine, siç quhej atëherë Kosova, por model i femrës emancipuese e i versionit të gjerë të veprimtarisë.

"Veprimtarinë e saj e shkriu në çlirim njerëzor dhe kombëtar të shqiptarëve", ka thënë Nushi.

Në mbledhjen komemorativë për të ndjerën, Vahide Hoxha, është lexuar edhe një telegram ngushëllimi nga Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare nga Tirana. Telegramin e ka lexuar mbesa e së ndjerës, Flaka Surroi.

"Me hidhërim të thellë mësojmë lajmin për ndarjen nga jeta të bashkëluftëtares sonë, veteranes së luftës antifashiste, Vahide Hoxha. Vdekja e saj është humbje e madhe për familjen tuaj, për Shoqatën e Veteranëve të Luftës Nacionalçlirimtare të Kosovës, për mbarë shoqërinë", thuhet në telegram. "Vahide Hoxha ishte dhe do të mbetet simbol i trimërisë, mençurisë dhe i vlerave më të shquara të patriotizmit shqiptar, vlera këto të demonstruara gjatë gjithë jetës së saj", thuhet në telegramin e ngushëllimit e Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare nga Tirana.

Vahide Hoxha ka ndërruar jetë të premtën, pas një sëmundjeje të shkurtër, në moshën 87-vjeçare. Ajo ka lindur më 1926, në Prizren.

© KOHA Ditore

Të goftë i lehtë dheu i Kosovës!

Vehap Shita: Fjala mortore

E nderuar zonja VAHIDE HOXHA, kryetare e Shoqatës së Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Kosovës, e dashura profesoreshë e shumë e gjeneratave që e dëgjuan fjalën tënde në orët e historisë në Gjinnazin e në Shkollën Normale të Prishtinës. E shumëçmuara qytetare dinjitoze e qytetit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe e kryeqytetit të Kosovës, Prishtinës, nuse e dashur e qytetit të Gjakovës. Po të dorëzojmë sot në amshim pranë bashkëshortit tënd të nderuar, luftëtar i paepur simbol i luftës për çlirimin e popullit shqiptar të Kosovës, për bashkimin kombëtar por edhe për shtetësinë e Kosovës - subjekt konstitutiv i Kosovës shtet që do të vetëvendosë për fatin e vet në gjirin e popujve të tjerë liridashës të Evropës dhe të botës, komandantit të

Shtabit Kryesor të Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe Aradheve Partizane të Kosovës, Fadil Hoxhës.

Të nderuar bashkëqytetarë, prof. Vahide Kabashi - Hoxha, e lindur më 26 qershor të vitit 1926 në Prizren, në një familje atdhetare arsimdashëse, ishte një ndër vajzat e rralla shqiptare të Prizrenit që, në kohën e Jugosllavisë mbretërore, arriti ta kryente semimaturën në Gjinnazin e Prizrenit në gjuhën serbokroate. Pas kapitullimit të Jugosllavisë dhe bashkimit të Kosovës me Shqipërinë atëherë të okupuar nga Italia fashiste dhe çlirimit të vendit kreu gjinnazin në Shkodër e Prishtinë dhe Fakultetin Filozofik - Degën e Historisë në Shkup e Beograd. Pasi shërbeu një kohë si profesoreshë e historisë në Gjinnazin dhe Shkollën Normale të Prishtinës, ishte edhe drejtoreshë e Muzeut dhe e Institutit të Historisë së Kosovës, kryetare e Bashkësisë së

Kulturës së Kosovës, deputete dhe delegate në Kuvendin e Serbisë e të Jugosllavisë dhe anëtare e Këshillit Ekzekutiv (Qeverisë) së Kosovës.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, si shumë e re dhe gjinnaziste iu bashkua rinisë antifashiste dhe mori pjesë në demonstrata e aktivitete të tjera në Prizren dhe Prishtinë. Në nëntor të vitit 1944 merr pjesë në Konferencën Themeluese të Lidhjes së Rinisë Antifashiste të Kosovës në Gjakovë si anëtare e delegacionit të Rinisë antifashiste të Prizrenit. Ishte kryetare e Komitetit të Vendit e të Rrethit të Prizrenit e të Prishtinës, anëtare e Kryesisë së Frontit të Gruas Antifashiste të Kosovës dhe ushtroi edhe funksione të tjera në jetën shoqërore, politike, kulturore e arsimore.

Gjatë rezistencës paqësore të popullit shqiptar të Kosovës kundër regjimit okupues serb në vitet '90 dhe

luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, krah për krah me bashkëshortin e vet, ishte në anën e popullit të vet liridashës duke mos u larguar për asnjë moment nga qyteti dhe pragu i vet. Në qershor të vitit 2005 u zgjodh kryetare e Kryesisë së Shoqatës së Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Kosovës, të cilën e udhëhoqi me shumë përkushtim e sukses deri në momentet e fundit. Nën udhëheqjen e Vahide Hoxhës dhe me firmën e saj Shoqata jonë iu drejtua opinionit tonë edhe tij botëror me fjalët: "Me shtetin serb të bisedohet vetëm në nivelin shtetëror" dhe "Kujdes! Serbia ka shkelur çdo marrëveshje politike prej okupimit të Kosovës në luftërat ballkanike derisot. Gjatë periudhës shumëvjeçare të sundimit serb shteti serb nuk i ka respektuar as aktet më të larta normative të veta, dhe, nën ndikimin e saj, edhe të ish-Federatës Jugosllave kur kanë pasur të bëjnë me shtpaëpt e Kosovës". Nën udhëheqjen e saj dhe me firmën e saj kemi botuar këto ditë librin "Shoqata

e Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare e Kosovës - Krah i luftës për çlirim, pavarësi, vetëvendosje e shtetësi të Kosovës në vitet 1990-2012".

Vdekja e papritur e Vahides na lë pa gëzimin e përrurimit të këtij libri - dokument identiteti i Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe i angazhimit të pjesëmarrësve të saj edhe në lëvizjen e rezistencës së përgjithshme popullore të popullit shqiptar të Kosovës e të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

E nderuara dhe e çmuara kryetare e Shoqatës së Veteranëve të LANÇ të Kosovës, ti po shkon sot për të pushuar në amshim pranë bashkëshortit tënd të nderuar nga populli i Gjakovës, i Kosovës dhe i mbarë shqiptarisë. Por kemi bindjen se pasardhësit tanë do të vazhdojnë rrugën tuaj të çlirimit të shtetformimit dhe të ndërtimit të Kosovës sonë martire liridashëse.

Të goftë i lehtë dheu i Kosovës. Lavdi, mirënjohje e falënderime. Gjakovë, 1 qershor 2013

SPECIALE

Dëshmitarët kundër komandantëve po masin durimin e veteranëve, por se kësaj gjëje i ka ardhur fundi

Në mbrojtje të UÇK-së, kundër EULEX-it

Veteranët e luftës së UÇK-së, përveç për EULEX-in patën porosi edhe për ata që besojnë se e ndihmojnë këtë mision në ngritjen e akuzave. Smajl Elezaj, thotë se dëshmitarët kundër komandantëve po masin durimin e veteranëve, por se kësaj gjëje i ka ardhur fundi.

Dhjetëra autobusë i shkarkuan udhëtarët prapa Pallatit të Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë, që kishin ardhur për të kërkuar lirinë e komandantëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Gjyqtari i procedurës paraprake të Gjykatës Themelore në Mitrovicë ka vendosur masën e arrestit shtëpiak prej 30 ditësh për shtatë të ndaluarit nën dyshimet se kanë kryer krime lufte, gjatë periudhës së luftës në Kosovë, në të burgun e supozuar të Likovcit.

Në mesin e të dyshuarve për krime lufte është edhe kryetari aktual i komunës së Skenderajt, Sami Lushtaku, ambasadori i Kosovës në Shqipëri, Sylejman Selimi, Sahit Jashari, Jahir Demaku, Zeqir Demaku, Hysni Thaçi e Avni Zabeli.

Me flamuj të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, nën organizimin e shoqatave të dala nga lufta, mijëra qytetarë kanë protestuar të hënë më 28 Maj kundër misionit evropian për sundimin e ligjit, EULEX.

"UÇK! UÇK! Poshtë EULEX-i! Poshtë EULEX-i! Nuk kanë ccka bëjnë tanët me EULEX-in! Rroftë UÇK-ja!" thërriste me zë kryetari i Veteranëve të Luftës në Drenas, Enver Hajdari.

Rrahman Ramadani, kishite nxjerr nga dollapi uniformën e ushtarit, dhe flamurin e UÇK-së, dhe nga fshati Zajqevc iu bashkua protestës në Prishtinë. "Kjo është një përkrahje për luftën e drejtë tonën të UÇK-së. Po i ndjek padrejtësisht EULEX-in, e ka një fushatë të egër kundër ushtarëve, sidomos kundër ushtarëve të lirisë", tha Ramadani për Radion Evropa e Lirë, ndërsa argumenton se misioni evropian po bënë ndjekje shtrigash.

"Po pse nuk po bënë kur njëfarë hapi për t'i ndjekur kriminelët serbë, por veç këta tanët, pa bërë kurrë njëfarë krimi, pa pas kurrë njëfarë argumenti?!", tha ish-ushtari i UÇK-së.

Smajl Elezaj, që vepron si nënkryetar i Organizatave të



Veteranëve të UÇK-së, tha para protestuesve se veprat për të cilat akuzohen komandantët e UÇK-së, paraqesin, siç tha ai, "baltojsje të dëshmorëve të kombit dhe luftëtarëve të gjallë", dhe se me këto veprime po cenohet liria dhe siguria. "Jemi në momente kritike, po kanosemi nga ajo që nuk e kemi dëshiruar asnjëherë. Kosova si shtet po kanoset nga destabilizimi, dhe jemi në rrezik që të gjithë ato që ndërtoam bashkërisht, do të shkatërrohet", porositi Elezaj.

Kjo gjendje, sipas veteranëve është e patolerueshme, andaj organizatat e dala nga lufta, duan që qeveria t'ua dëgjtojë zërin. "Për këtë arsye, sot më shumë se kurrë, na duhet unifikim i përpjekjeve dhe qëndrimeve, që Kosova si shtet të bëjë hapin më të mirë që ka bërë prej shpalljes së pavarësisë, të merr vendim për ndërprerjen e misionit të EULEX-it, në të kundërtën do të jetë vështirë të mbahet nën kontroll

zemërimi i luftëtarëve, invalidëve dhe familjeve të dëshmorëve", tha Elezaj. "Ne sot u tubuam në paqe, në një protestë paqësore, dinjitoze. Por nuk jemi në gjendje të japim asnjë garanci, për veprime që mund të ndodh më pas, thirrjes së kaluar", shtoi ai.

Porosi për EULEX-in dha edhe aktivisti Adem Demaçi, i cili uroi që Evropa do ta shohë të vërtetën...

"Presim nga kjo Evropa ta shohin të vërtetën si duhet, dhe të veprojnë ashtu si duhet, e të mos bëjnë gabime, që ta cojnë popullin në këmbë, e të bëhet populli me forcë. Ne e kemi dëshirë që këto probleme të zgjidhen në mënyrë si duhet, të zgjidhen në mënyrë paqësore, në mënyrë njerëzore, në mënyrë të drejtë...Ne luftuam për lirinë tonë, dhe ne nuk mund të jemi kriminel", tha ai.

Protestës iu bashkua edhe një deputete e Partisë

Demokratike të Kosovës. Xhevahire Izaku tha për Radion Evropa e Lirë, se thirrja e veteranëve drejtuar qeverisë për rishikim të mandatit të EULEX-it, duhet marr seriozisht. "Është absurd të thirren liderët e UÇK-së dhe të akuzohen për krime lufte. Derisa në anën tjetër, dihet që s'ka bërë asnjë hap për kapjen e kriminelëve, që edhe janë të identifikuar. Konsideroj se është shumë i ngutshëm veprimi që ka bërë EULEX-i dhe absolutisht duhet të rishikohet EULEX-i", tha për Radion Evropa e Lirë deputetja Xhevahire Izaku.

Veteranët e luftës së UÇK-së, përveç për EULEX-in patën porosi edhe për ata që besojnë se e ndihmojnë këtë mision në ngritjen e akuzave. Smajl Elezaj, thotë se dëshmitarët kundër komandantëve po masin durimin e veteranëve, por se kësaj gjëje i ka ardhur fundi.

KOSOVA KËRKON PËRKRAHJEN E LITUANISË GJATË KRYESIMIT TË PRESIDENCËS SË BE-së

Ministri i Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës, Enver Hoxhaj, priti në një takim të ngarkuarin me punë të Republikës së Lituanisë në Sofje, Darius Gaidys, misioni i të cilit e mbulon edhe Kosovën.

Gjatë takimit, ministri Hoxhaj vlerësoi raportet shumë të mira ndërmjet dy shteteve, duke shprehur vullnetin e Qeverisë së Kosovës për fuqizimin e mëtejshëm të marrëdhënieve bilaterale me Lituaninë.

Hoxhaj foli edhe për progresin në Kosovë, konsolidi-

min e vazhdueshëm të shtetësisë dhe subjektivitetit ndërkombëtar të Republikës së Kosovës.

Në këtë kontekst, Hoxhaj theksoi avancimin e axhendës euro-integruese të Republikës së Kosovës.

I ngarkuari me punë të Republikës së Lituanisë në Sofje, Darius Gaidys, i cili gjatë këtij takimi ka dorëzuar edhe letrat zyrtare për mbulimin e Kosovës nga Ambasada e Lituanisë në Bullgari, theksoi përkrahjen e vendit të tij për proceset në Kosovë.

Ministri Hoxhaj dhe z. Gaidys diskutuan edhe për përkrahjen e Lituanisë për Kosovën gjatë periudhës Korrik-Dhjetor 2013, kur Lituania do të ketë kryesimin e presidencës së Bashkimit Evropian.

Në këtë kontekst, Gaidys theksoi se Kosova do të mbetet prioritet i presidencës lituaneze të BE-së.

Gjatë takimit u bisedua edhe për vizitën që ministri i Jashtëm i Lituanisë pritet të zhvillojë në Republikën e Kosovës në korrik të këtij viti.

Lançohet projekti "Mbështetje përpjekjeve kundër korrupsionit në Kosovë"

KOSOVA, PRIORITET MBI PRIORITETET SUNDIMIN E RENDIT DHE LIGJIT

Prioritet mbi prioritetet për Republikën e Kosovës është sundimi i rendit dhe ligjit, ka deklaruar zv/kryeministri kosovar dhe ministri i Drejtësisë, Hajredin Kuçi. Ai kërkoi ngritjen e kapaciteteve njerëzore në sistemin gjyqësor dhe në organet e tjera që merren me luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar, sepse sipas tij, Kosova ka infrastrukturë ligjore në luftimin e këtyre dukurive.

Zv/kryeministri Kuçi mori pjesë në lancimin e projektit "Mbështetje përpjekjeve kundër korrupsionit në Kosovë" (SAEK), nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).

Ky projekt, i financuar nga Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (SDC), ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve të Agjencisë Kundër Korrupsion (AKK), rritjen e angazhimit qytetar në forcimin e transparencës e llogaridhënies, qasjen në informata në nivel lokal përmes mediave sociale dhe të forcojë aftësinë e gjyqësorit për të luftuar korrupsionin nga brenda dhe jashtë. Përmes një qasjeje inovative dhe gjithëpërfshirëse projekti SAEK do të marrë në konsideratë nivelet e ndryshme të intervenimit, duke bashkëpunuar drejtpërdrejt me autoritetet e qeverisjes qendrore, aktorë lokalë komunalë, shoqërinë civile dhe me vetë qytetarët.

PRISHTINË, HOXHAJ VLERËSON PËRKRAHJEN E NATO-s PËR KOSOVËN

Ministri i Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës, Enver Hoxhaj, priti më 29 maj në takim një delegacion të Nënkomisionit të Asamblesë Parlamentare të NATO-s.

Gjatë takimit me delegacionin e përbërë nga Marit Nybakk, kryetare, Beatriz Rodriguez-Salmones, nënkryetare dhe Daniel Bacquellaine, raportues, ministri Hoxhaj informoi për progresin e vazhdueshëm që po arrihet në Republikën e Kosovës, duke përfshirë edhe fuqizimin e sektorit të sigurisë.

Ministri Hoxhaj, sipas zyrës së tij, shprehu mirënjohjen e popullit të Kosovës për përkrahjen që NATO dhe të gjitha shtetet anëtare të saj po japin për Kosovën, në garantimin e një ambienti të sigurt.

Hoxhaj informoi anëtarët e delegacionit se Kosova mbetet vendi me përkrahjen më të madhe publike në raport me integrimin në NATO, me mbi 90% të popullsisë që përkrahin një proces të tillë.

Në këtë kontekst, ai theksoi përkushtimin e Republikës së Kosovës për forcimin e partneritetit me NATO-n.

Ndërkaq, anëtarët e delegacionit të Asamblesë Parlamentare të NATO-së vlerësuan progresin në Kosovë, duke shprehur përkrahjen e tyre për avancimin e proceseve në Kosovë.

Ministri Hoxhaj dhe anëtarët e delegacionit të NATO-së biseduan edhe për avancimin e proceseve integruese euroatlantike të Kosovës, si dhe për proceset e anëtarësimit të Kosovës në nismat rajonale dhe organizatat ndërkombëtare, me ç'rast, Hoxhaj e vlerësoi vendimtare për Kosovën, përkrahjen e NATO-së në këto procese.

Ministri Hoxhaj gjatë takimit u përgjigj në shumë pyetje që kishin të bëjnë me transformimin e FSK-së, të ardhmen e marrëdhënieve me NATO-n si dhe bashkëpunimin me KFOR-in dhe EULEX-in.

HISTORIA

Fterra qëndroi gjatë kohës së Luftës NÇL në frontin e parë si një nga portat kryesore të Kurveleshit

Çeta e Fterrës gjatë Operacionit Armik të Qershorit 1944

• Pas Operacionit të Qershorit, armiku nuk ishte më në gjendje të ndërmerre operacione të tjera. Në gusht 1944 u bë një sulm nga Borshi në drejtim të Fterrës, por nga kundërsulmi i Brigadës së 12-të S dhe forcave territoriale, armiqtë u detyruan të tërhiqen. Pas Operacionit të Qershorit u zgjerua aktiviteti politik në fshat. Përveç të rinjve që kishin mbushur radhët e ushtrisë partizane, pesë nga të cilët kishin dhënë jetën në atë periudhë për çlirimin e vendit, të rinjtë dhe të rejtat e Fterrës u mobilizuan në aktivitete kulturore e arsimore, edhe në fshatrat e tjera të Kurveleshit e të Bregdetit

Operacioni armik i prillit 1944

Nga Operacioni i Dimrit Ushtria Partizane dhe tërë Lëvizja NCL dolën më të fuqishme. Armiqtë pas muajit mars vendosën të zhvillojnë përsëri një operacion të madh për të shkatërruar ushtrinë partizane. Veprimet nisën në fillim të prillit. Ky ishte operacioni i katërt armik që ndërmerren pushtuesit nga Vlora, drejt Himarës, Vranishtit e Luginës së Shushicës, nga Saranda drejt Borshit. Në këtë situatë u muar vendim që të mbrohej Kurveleshi i Poshtëm, ku bënte pjesë edhe Çeta e Fterrës. Gjermanët arritën në Kuç, por pas pesë orë luftimesh armiqtë pushuan zjarrin dhe të nesërmen u larguan, jo vetëm nga Kuçi, por nga i gjithë Kurveleshi. Në këto luftime u vra zv/komandanti i Brigadës së 5-të S. Dervish Hekali dhe një partizan.

Kongresi Antifashist në Përmet më 24 Maj 1944

Gjatë pranverës 1944 territori i qarkut tonë ishte nën kontrollin e ushtrisë partizane dhe këshillave NCL, me përfshirje të Sarandës, Delvinës e Gjirokastrës. Në Fterrë organizatat e rinisë dhe gruas zhvillonin veprimtari të dendur politike, për demaskimin e armiqve, për rritjen e vigjilencës, për pjesëmarrjen në luftën e armatosur, për ndërtimin e shtëpive të djegura e të shkatërruara, për mobilizimin e të gjithë fshatarëve në çetën territoriale të fshatit dhe në batalionin e Kurveleshit të Poshtëm etj. Në lëmin politik, populli ynë ishte i lidhur me Partinë dhe Frontin ANCL, ndërsa në fushën ekonomike krijoheshin vështirësi serioze. Prandaj për Këshillin ANCL të fshatit mbeteshin në rendin e ditës dy probleme kryesore: furnizimi i popullit me bukë dhe strehim. Për strehimin u

morën masa për rindërtimin e shtëpive brenda mundësive dhe nevojave të ngutshme të secilës familje. Më shqetësuese mbetej siguri i bukës për popullin, sepse rezerva nuk kishte, sidomos pas operacioneve. Bujqësia ishte në vështirësi. Kontaktet me qytetin ishin ndërprerë. Për përmirësimin e gjendjes, ndihmuan komunistët, rinia, aktivistët. Vështirësitë e një familjeje u bënë vështirësi për tërë fshatarët, duke zbatuar ndihmën vëllazërore për njeri tjetrin. Ndihma të tilla organizoheshin edhe për familjet që i kishin djemtë partizanë. Veprimtaria e Këshillit NCL ishte edhe zgjedhja e delegatëve për në Kongresin Antifashist të Përmetit. Nga Fterra u zgjodh përfaqësues i popullit Safet Memi, i cili mori pjesë në mbledhjen krahinore, nga e cila u zgjodhën delegatët e Kongresit. Delegat për në Kongresin e Përmetit, si përfaqësues i

forcave territoriale dhe popullit. Okupatorët dhe tradhtarët organizuan operacionin tjetër të përgjithshëm me forca më të shumta, me qëllim që të asgjësonin Ushtrinë NCL, Frontin dhe Këshillat NCL. Operacioni nisi më 5 qershor për të asgjësuar forcat partizane në Mesaplik, Kurvelesh, Bregdet me qëllim që të dilnin në Kuç e në Borsh, në shpinë të forcave partizane që vepronin nga Dhërmiu në Shënvasi. Kurveleshi u sulmua përmes Kalasës, Malit të Gjerë, Kardhiqit, Bënçës, Salarisë, Shushicës, nga Llogorai drejt Himarës. Çeta Vullnetare "Fuat Mato" e Fterrës së bashku me Brigadën e 6-të S, Grupin e Parë të Kurveleshit, zunë pozicione në Borsh, Bërdë dhe Qafën e Rrëmuullës ku u zhvilluan përleshje të përgjakshme. Armiqtë nga të gjitha anët hynë në krahinën e Kurveleshit. Në Shur të Kuçe ishin grumbulluar



listët bënë djegje shtëpish, plaçkitje e dëmtime të shumta. Populli i Fterrës tregoi kujdes për furnizimin e partizanëve që gjendeshin në pyjet e fshatit me ushqime e veshmbathje. Ndihmë të veçantë dhanë rinia dhe gratë e fshatit. Pas operacionit të gjithë u kthyen në fshat. Këshilli NCL, çeta vullnetare, organizatat e rinisë dhe të gruas vazhduan të kryejnë detyrat e caktuara. Pas Operacionit të Qershorit, armiku nuk ishte më në gjendje të ndërmerre operacione të tjera. Në gusht 1944 u bë një sulm nga Borshi në drejtim të Fterrës, por nga kundërsulmi i Brigadës së 12-të S dhe forcave territoriale, armiqtë u detyruan të tërhiqen. Pas Operacionit të Qershorit u zgjerua aktiviteti politik në fshat. Përveç të rinjve që kishin mbushur radhët e ushtrisë partizane, pesë nga të cilët kishin dhënë jetën në atë periudhë për çlirimin e vendit, të rinjtë dhe të rejtat e Fterrës u mobilizuan në aktivitete kulturore e arsimore, edhe në fshatrat e tjera të Kurveleshit e të Bregdetit. Mund të përmendim organizimin e grupit teatral të Fterrës, i cili vuri në skenë dramën "Lulja e Kujtim-it" të Foqion Postolit, si dhe disa skeçe të tjera ku demaskoheshin e viheshin në lojë ballistët e gjermanët. Përveç Fterrës çfaqja u dha në

Çorraj, Kuç, Pilur, Kudhës, Qeparo, Himarë, Piqerras, Tatzat, Lukovë, Delvinë, Sarandë. Këto aktivitete luajtën një rol të madh edukativ për rritjen e patriotizmit tek fshatarët, sidomos në Bregdet. Në grupin teatral bënë pjesë Ismet Elezi, Shaban Mita, Dilaver Shkurti, Rait Braho, Eqerem Kofina, Resul Mita, Lutfi Dusha, Luan Dusha etj. Aktivitet tjetër ishte hapja e shkollave në zonat e lira. Për këtë qëllim në gusht 1944 Lame Xhama, Xhevdet Kofina, Ismet Elezi, Dilaver Shkurti dhe Rait Braho morën pjesë si delegatë në mbledhjen e organizuar nga Këshilli NCL i Qarkut të Gjirokastrës në Lypë të Përmetit. Aty u dhanë udhëzime për hapjen e shkollave në zonat e lira. Në mbledhje folën të deleguar, midis të cilëve Sejfulla Malëshova. Të rinj e të moshuar që kishin qënë në shkollat e mesme, u ngarkuan për të çelur shkollat fillore në Fterrë, Çorraj, Kuç dhe në shumë fshatra të tjera, deri në krahinën e Rrëzomës e Bregdetit. Në Fterrë u caktuan Naim Zani dhe Sirri Bezhani. Në gusht 1944 në Helmës të Skraparit, zhvilloi punimet Kongresi i Parë i Rinisë Antifashiste. Kongresi i dha një impuls të ri aktivitetit të rinisë në Fterrë. Në këtë Kongres morën pjesë tre delegatë fterjotë nga

ushtria partizane: Bilal Dusha, Nafiz Bezhani dhe Liri Fterra. Disa nga të rinjtë u ngarkuan me drejtimin e rinisë, përveç Fterrës, edhe në krahinën e Kurveleshit e të Tepelenës. Ismet Elezi e Dilaver Shkurti gjatë vitit 1944 kanë qënë të caktuar anëtarë të Komitetit të Rinisë të rrethve të Kurveleshit e Tepelenës, ndërsa Rait Braho në Kurveleshin e Poshtëm. Safet Memi, përveç detyrës si sekretar i celulës në Fterrë-Çorraj, u ngarkua me detyrën e sekretarit në Komitetin e Partisë të Kurveleshit.

Të rinjtë e Fterrës kanë marrë pjesë gjithashtu në Konferencën e Rinisë të Rrethit të Kurveleshit në Progonat dhe në Konferencën e Qarkut në Gjirokastrë.

Nga fshati ynë, me një popullsi 550 vetë, ose rreth 100 familje, morën pjesë në repartet partizane të rregullta 45 vetë, pa përmendur këtu pjesëtarët e tjerë të armatosur herë pas here, të cilët merrnin pjesë direkt në luftime. Shumë gra dhe vajza ndihmuan partizanët me ushqime, veshmbathje e strehim. Fterra qëndroi gjatë kohës së Luftës NÇL në frontin e parë si një nga portat kryesore të Kurveleshit.

(Marre nga libri i z. Dilaver Shkurti "Fterra Kasabaja Labe...")



Ushtrisë Partizane për Zonën e Parë Operative, u zgjodh Mehmet Dusha.

Operacioni i qershorit 1944

Në pranverën e vitit 1944 u spastruan nga armiqtë gati të gjitha krahinat në Jug të vendit. Kjo ngriti lart gjendjen moralo-politike të partizanëve,

shumë forca partizane vullnetare, popull, gra, pleq e fëmijë, të larguar nga fshatrat, për të mos rënë në duar të hitlerianëve. Forcat partizane e vullnetare u shpërndanë në drejtime të ndryshme.

Çeta e Fterrës dhe forcat e tjera partizane u tërhoqën, duke manovruar në prapavijat e armikut. Gjermanët dhe bal-

PËRKUJTIMORE

EVOKIME PËR SHABAN, HYSNI E MUSA ZAJMIN

Vehap SHITA

Më 17 Maj 2013, në Gjakovë u mbajt një akademi përkujtimore për Shaban, Hysni e Musa Zajmin. pPjesëmarrësit në akademi, familjarët e familjes Zajmi dhe organizuesit e këtij tubimi i përshëndeti Agim Koci, nënkryetar i komunës së Gjakovës, e folën edhe akademik Pajazit Nushi, nënkryetar i Shoqatës së Veteranëve të LANÇ të Kosovës, dhe Skender Hoxha, kryetar i Degës së kësaj Shoqate në Gjakovë. Në emër të anëtarëve të familjes Zajmi, falënderoi dr. Shkëlzen Zajmi.

Një kumtesë në akademinë përkujtimore të Familjes Zajmi, organizuar nga Shoqata e Veteranëve të LANÇ të Kosovës - Dega në Gjakovë dhe Shoqata e intelektualëve "Jakova" - me rastin e 70-vjetorit të vrasjes së vëllezërve Hysni e Musa Zajmi, mbajti edhe z.Vehap Shita. Më poshtë pobotomjë të plotë kumtesën e tij.

Kumtesën time për këtë akademi përkujtimore e kam quajtur EVOKIME PËR SHABAN, HYSNI E MUSA ZAJMIN - i pari anëtar i Këshillit Nacionalçlirimtar të Gjakovës në kohën e Luftës së Dytë Botërore, e pas luftës anëtar, nënkryetar e kryetar i këtij këshilli, Hysni mësues normalist i Elbasanit në Shqipëri, në Gjakovë e Vrellë të Istokut dhe Musa Zajmi shegert e kallfë në rrobaqepësinë e Ramiz Rokës në Gjakovë, të dy dëshmorë të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare - të vrarë nga policia nazifashiste italo-gjermane e bashkëpunëtorët shqiptarë në shërbim të okupatorëve.

Për të tre foli më gjerësisht akademik Pajazit Nushi dhe unë do të përpiqem të mos i përsëris ato që tha këtu i nderuari prof. Nushi. Por, do t'i kujtoj në formë evokimesh disa detaje nga ato që i mbaj në mend të ravizuara në kujtesën time nga periudha kur i kam njohur.

Shaban Zajmi rrjedh nga familja e nderuar Zajmi, e cila në analet e qytetit të Gjakovës për-

mendet që para dyqind e sa vjetësh. Nga kjo familje kanë dalë atdhetarë e arsimdashës të dëgjuar që kanë lënë gjurmë në jetën dhe në zhvillimin e qytetit dhe të rrethit të Gjakovës. Qytetar i nderuar, atdhetar e arsimdashës Shaban Zajmi ishte edhe kryeplak i mëhallës së Haxhi Ymerit në të gjitha periudhat që nga vitet e hershme të tridhjeta të shekullit të kaluar, gjithnjë krah i fortë i bashkëqytetarëve të vet. Njeri i ditur e arsimdashës Shaban Zajmi edhe djalin e vet më të madh, Hysniun, fill pas shkollës fillore do ta dërgojë në shkollë të mesme. Kështu Hysniu ishte nxënës në gjeneratën e parë të Medresesë së Madhe të Shkupit, shok klase me Hivzi Sulejmanin, shok shkolle me vëllanë e Hivziut, Azizin, gjithashtu dëshmor i LANÇ, e me disa nxënës shokë që do të bëhen emër në Lëvizjen Nacionalçlirimtare të asaj kohe si Rifat Burxheviqi, Avdo Abdagiqi, Idriz Ajeti Gashi, gjithashtu dëshmor i LANÇ, Abdurrahman Hajdarpasha, Hasan Hakuu etj. Aty, besoj, Hysniu edhe u frymëzua me idetë e punës e të luftës për çlirim, liri e drejtësi sociale.

Por i edukuar në familje në frymën e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, të çlirimit e të bashkimit kombëtar, Hysniu, fill pas kryerjes së semimaturës në këtë shkollë, do të kalojë në Shqipëri për t'u shkolluar në gjuhën amtare shqipe. Dhe, me të kryer Shkollën Normale të Elbasanit, do të punojë ca vjet mësues në Shqipëri për t'u kthyer në vendlindje në Kosovë fill pas shpërbërjes së Jugosllavisë pas kapitullimit të saj para ushtrive nazifashiste në prill të vitit 1941.


Ky okupacion i ri i vendit tonë kishte edhe një të mirë. Me përfundimin e okupacionit të urryer serbo-jugosllav po fillonte një periudhë e re e frymëmarrjes më të lirë të shqiptarëve me hapjen e shkollave shqipe, administratën shqipe, gjyqësinë e policinë, madje edhe ushtrinë shqiptare ndonëse nën okupacionin nazifashist.

Ky ishte edhe rrezik i madh që shqiptarët në përgjithësi, e shqiptarët e Kosovës e të viseve të tjera shqiptare që deri atëherë

kishin qenë nën Jugosllavi në veçanti, të merrnin anën e okupatorëve nazifashistë dhe fundi i Luftës së Dytë Botërore t'i zinte në anën e bllokut fashist që do ta humbte luftën e bashkë me të edhe shqiptarët do ta humbnin të drejtën e vetëvendosjes dhe të shkëputjes nga shtetet okupuese sllavo-greke. Atëherë Hysniun do ta takojmë në vendlindjen e tij në Gjakovë, kur, bashkë me shokët e vet kosovarë, gjithashtu të shkolluar në Shqipëri, do të hapin shkolla e kurse në gjuhën shqipe dhe do të vënë bazat e arsimit shqip në Kosovë për të arritur sot deri te fakultetet, universitetet, institucionet kulturore e shkencore deri te Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës.

Atëherë, me Konferencën e Bujanit dhe Rezolutën e saj për vetëvendosjes deri në shkëputje e bashkim kombëtar, do të vihen edhe themelet e shtetësisë së Kosovës që, si subjekt i lirë e sovran, të vendosë për fatin e vet. Hysniut mësues në Gjakovë e Vrellë të Istogut, sekretar i Komitetit të Rinisë Antifashiste e anëtar i Këshillit Nacionalçlirimtar të qytetit e të rrethit të Gjakovës do t'i bashkohet edhe babai i tij, Shaban Zajmi, e rinisë antifashiste edhe vëllai i tij më i vogël, Musa Zajmi, që nga kallfa i rrobaqepësisë së Ramiz Rokës do të bëhet sekretar i rinisë në qytetin e vet e anëtar i Partisë Komuniste e cila atëherë u printe organizatave antifashiste e grupeve guerile. Musai i ri entuziast, i vendosur e guximtar, do të marrë pjesë aktive në aksionet e grupeve guerile, në shpërndarjen e trakteve e të komunikatave, në prerjen e telave e rrezimitin e shtyllave të telefonit e do të bëhet partizan e zëvendës-komisar i aradhes partizane që do të luftojë me armë në dorë për çlirimin e Kosovës deri sa para 70 vjetësh do të bjerë dëshmor nga pushka e armikut në Livoç të rrethit të Gjilanit më 13 prill të vitit 1943.

Jo vetëm Hysniu e Musai që ranë dëshmorë në fushën e nderit, por edhe vëllai i tyre më i vogël, Naimi, e motra Nakija do të jenë pionierë e të rinj antifashistë të guximshëm. Naimi do ta vazhdojë punën e luftës në



Busti i Musa Zajmit (1923-1943) në Shkollën Fillore të Gjilanit që mban emrin e tij

Lëvizjen çlirimtare pas vrasjes së vëllezërve e vdekjes së babait edhe pas Luftës së Dytë Botërore duke iu bashkuar grupeve rezistente ndaj regjimit dhe politikës së qarqeve nacional-shoviniste të maskuara nën petkun komunist që u demaskuan së fundi në vitet tetëdhjetë e nëntëdhjetë dhe e humbën luftën nën sulmet e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe me ndërhyrjen efektive të forcave të Aleancës Veriatlantike - NATO-s të prira nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës e Unioni Evropian dhe të përkrahura nga mbarë Bashkësia ndërkombëtare.

Dhe, fare në fund, edhe një detaj për kreun e familjes Zajmi në ditët e Luftës së Dytë Botërore dhe fill pas saj Ishte atëherë Shaban Zajmi, bashke me disa burra gjithashtu të nderuar të qytetit e të rrethit të Gjakovës si Tafa i Aliagës, Din Lama, Faik Dushi, Hamdi Shehu, Hysni Hima, Sheh Danjoll, Sulejman Domi, Hysen Agë Batusha, Caja i Dautagës, Hafiz Guta, Tun Marku, Qamil Gojani, Ramadan Boshtri, Hysen Hasani, Ukshin

Myftari e të tjerë që i dolën zot qytetit e fshatrave të rrethit të Gjakovës dhe e mbrojtën nga vërshullja e okupatorëve e bashkëpunëtorëve të tyre duke e parandaluar terrorin fashist si ai që ishte ushtruar në Pejë e qendra të tjera, edhe pse pikërisht Gjakova, e shpallur atëherë si "Gjakova e Kuqe" ose edhe "Moska e vogël", ishte paraparë të digjej flakë e të masakrohej edhe më keq se Peja fqinje, dhe të përsëritej terrori që e kishte përjetuar Gjakova jo plot një vit më parë.

Ishte kjo një pjesëz e asaj që arritëm të evokonim në këtë tubim në shenjë kujtimi dhe falënderimi e mirënjohjeje për familjen Zajmi që i dhuroi bijtë e vet çlirimit e lirisë së Gjakovës e rrethinës dhe mbarë Kosovës për çlirim e bashkim kombëtar të shqiptarëve të Kosovës e të mbarë trojeve shqiptare të mbetura për më se një shekull nën sundim të të huajve. Nderim e evari familjes Zajmi. U kujtoftëshin për jetën e mot martirët, trimat e dëshmorët që e flijuan jetën e tyre në altarën e atdheut. Ju falem nderit.

AKTUALITET

Presidenca shpalli konkursin kombëtar edhe për ideimin, e dekoratave dhe titujve të nderit

Konkurs kombëtar për simbolet e Institucionit të Presidentit

Faza e realizimit të objekteve: flamur, logo, dekorata dhe tituj nderi do të ndiqet nga një grup specialistësh dhe nga artisti fitues, me qëllim ruajtjen e cilësisë dhe saktësisë së imazheve fitues

30 maj 2013 - Presidenca e Shqipërisë shpalli konkursin kombëtar për ideimin, modelimin dhe realizimin e simboleve të Institucionit të Presidentit, të dekoratave dhe titujve të nderit që jepen nga Presidenti i Republikës, bazuar në nenin 6 pika 3 të ligjit nr. 112/2013, datë 4.04.2013 "Për Dekoratat, Titujt e Nderit, Medaljet dhe Titujt Vendorë të Nderit në Republikën e Shqipërisë".

Simbolet janë:

- Flamuri i Institucionit të Presidentit të Republikës (përmasat të jenë 1x1.4 m)

- Logo e Institucionit të Presidentit të Republikës.

Dekoratat dhe Titujt:

-Dekorata "FLAMURI KOMBËTAR", e cila u jepet personaliteteve shqiptare dhe të huaja për merita të jashtëzakonshme për lartësimin e shtetit dhe të kombit shqiptar. (përmasa jo më e madhe dhe as më e vogël se diametri 6 cm)

-Dekorata "GJERGJ KASTRIOTI SKËNDERBEU", e cila u jepet personaliteteve shqiptare dhe të huaja për ndihmesë të qenësishme ose kontribut madhor në mbrojtjen, forcimin apo përparimin e faktorit shqiptar kudo në botë. (përmasa jo më e madhe dhe as më e vogël se diametri 5 cm)

-Dekorata "NDERI I KOMBIT", e cila u jepet personaliteteve shqiptare, që me veprat dhe emrin e tyre, nderojnë kombin shqiptar brenda dhe



jashtë vendit. (përmasa jo më e madhe dhe as më e vogël se diametri 5 cm)

-Dekorata "NËNË TEREZA", e cila u jepet personaliteteve shqiptare dhe të huaja për akte të shquara humanizmi ndaj kombit shqiptar dhe njerëzimit. (përmasa jo më e madhe dhe as më e vogël se diametri 5 cm)

-Dekorata "EARTË E SHQIPONJËS", e cila u jepet personaliteteve shqiptare dhe të huaja për trimëri në luftën e armatosur dhe për veprimtari ose akte të guximit qytetar në kohë paqeje. (përmasa jo më e madhe dhe as më e vogël se diametri 5 cm)

-Dekorata "PISHTAR I DEMOKRACISË", e cila u jepet personaliteteve shqiptare dhe të huaja për shërbime të shquara dhe sakrificat të kryera për kombin shqiptar dhe demokracinë. (përmasa jo më e madhe dhe as më e vogël se diametri 5 cm)

-Titulli "KALORËS I URDHËRIT TË SKËNDERBEUT", i cili u jepet personaliteteve shqiptare dhe të huaja për akte të veçanta heroike në mbrojtjen, forcimin dhe përparimin e Republikës së Shqipërisë. (përmasa jo më e madhe dhe as më e vogël se diametri 4 cm)

-Titulli "KALORËS I URDHËRIT TË FLAMURIT", i cili u jepet personaliteteve shqiptare dhe të huaja për veprimtarinë e tyre të dobi të shtetit dhe kombit shqiptar. (përmasa jo më e madhe dhe as më e vogël se diametri 4 cm)

-Titulli "MARTIR I DEMOKRACISË", i cili u jepet personaliteteve shqiptare dhe të huaja, që janë martirizuar për veprimtarinë e tyre të shquar për lirinë, demokracinë dhe përparimin shoqëror të Republikës së Shqipërisë. (përmasa jo më e madhe dhe as më e vogël se diametri 4 cm)

-Titulli "MJESHTËR I MADH", i cili u jepet punonjësve të fushave

të ndryshme të shkencës, artit, sportit, drejtimit, prodhimit dhe biznesit për punë të shquara dhe kontribut thelbësor në zhvillimin e sektorit. (përmasa jo më e madhe dhe as më e vogël se diametri 4 cm)

-Titulli "NAIM FRASHËRI", i cili u jepet personaliteteve shqiptare dhe të huaja, punonjësve të shkencës, artit, sportit, drejtimit, prodhimit dhe biznesit për punë të shquara në lartësimin Republikës së Shqipërisë në fushën përkatëse. (përmasa jo më e madhe dhe as më e vogël se diametri 4 cm)

-Titulli "PËR MERITA TË VEÇANTA CIVILE", i cili u jepet personaliteteve shqiptare dhe të huaja për merita të veçanta civile në Republikën e Shqipërisë. (përmasa jo më e madhe dhe as më e vogël se diametri 4 cm)

Në konkursin kanë të drejtë të marrin pjesë artistë, studio grafike dhe subjekte të interesuara (fizikë apo juridikë) me kombësi shqiptare.

Në konkurs pranohen punime individuale dhe punime të realizuara në grup. Subjektet pjesëmarrës duhen të paraqesin deri në 1 punim origjinal, për secilin objekt si: flamurin, logon, dekoratat dhe titujt, punime të cilat duhet të jenë origjinale, të papublikuara dhe autori mban përgjegjësi ligjore për autencitetin e tyre para ligjit. Konkursi nuk është i hapur për studentët.

Punimi (flamuri, logo) duhet të jenë shprehje artistike figurative grafike. (vetëm një punim artistik nga i njëjti subjekt).

Punimi (dekorata dhe tituj) duhet të jetë shprehje artistike figurative grafike dhe shprehje artistike figura-

tive e imazhit të dekoratës dhe titullit të nderit me prerje teknike për realizim. (2/dy punime artistike, një pamje figurative artistike + një pamje figurative e prerjes teknike të pamjes së dekoratës apo titullit të nderit).

Konkursi do të organizohet nga Institucioni i Presidentit dhe mbledhja e e punimeve do të nisë nga data 22.07.2013 deri më datë 30.07.2013. Pas kësaj date nuk do të pranohet asnjë punim për konkurim.

Subjektet e interesuara duhet t'i dorëzojnë dhe regjistrojnë punimet pranë Presidencës.

Me përfundimin e konkursit dhe pas shpalljes së boccitit fitues, ndërmjet artistit, grupit të artistëve dhe Institucionit të Presidentit, lidhet një kontratë akt-marrëveshjeje për pagesën, kushtet e modelimit dhe realizimit të mëtejshëm të objekteve: flamur, logo, dekorata dhe tituj nderi.

Faza e realizimit të objekteve: flamur, logo, dekorata dhe tituj nderi do të ndiqet nga një grup specialistësh dhe nga artisti fitues, me qëllim ruajtjen e cilësisë dhe saktësisë së imazheve fitues.

Ndërkohë, Komisioni Përzgjedhës do t'i shqyrtojë punimet nga data 31.07.2013 deri më datën 02.08.2013.

Me shpalljen publike të konkursit kombëtar të interesuarit mund të informohen mbi kushtet e këtij konkursi, nëpërmjet tërheqjes së materialit të shkruar pranë recepsionit të Institucionit të Presidencës si dhe nëpërmjet: website-t të Institucionit të Presidentit. Për çdo informacion mund t'i drejtoheni Institucionit të Presidentit në numrin etel: +35542389822.

Zhvilloi punimet, Takimi Plenar i Pranverës i Komitetit të NATO për Menaxhimin e Trafikut Ajror

Menaxhim sa më i mirë i trafikut ajror të NATO

Anëtarësimi i Shqipërisë në NATO në vitin 2009, shënoi sfidën e parë të rëndësishme për Forcën Ajrore shqiptare dhe ANTA. Bashkëpunimi i shkëlqyer ndërmjet Forcës Ajrore dhe ANTA, me mbështetjen e fuqishme të komponentit ajror të NATO, në Izmir dhe SHAPE, sollën suksesin që ne përjetojmë sot, policimin ajror mbi qiellin shqiptar

Në ambientet e hotel "Tirana International", më 28-30 maj 2013 zhvilloi punimet, Takimi Plenar i Pranverës i Komitetit të NATO për Menaxhimin e Trafikut Ajror (ATMC). Ky është një takim që mbahet dy herë në vit dhe këtë radhë Shqipëria ishte i pranishëm shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, gjeneralmajor Xhemal Gjunksi, drejtues të Forcës Ajrore, përfaqësues nga Agjencia Nacionale e Trafikut Ajror (ANTA) dhe autoriteti i Aviacionit Civil, ushtarakë nga Forcat Ajrore, etj. Gjithashtu në Takimin Plenar të Pranverës për Menaxhimin e Trafikut Ajror ishin të pranishëm 70 pjesëmarrës nga vendet anëtare të NATO, si dhe nga vendet e PFP. Qëllimi i zhvillimit të këtij takimi plenar është diskutimi dhe amendimi i politikave dhe udhëzimeve për një menaxhim sa më të mirë të trafikut ajror të NATO.

Në fjalën e përhëndetjes që mbajti shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, gjeneralmajor Xhemal Gjunksi, pasi i uroi mirëseardhjen pjesëmarrësve në konferencë, u shpreh se, ndi-

hem krenar që Shqipëria organizon dhe mirëpret këtë aktivitet. Mbi 20 vjet më parë, muret ndarëse të kufijve arrinin deri në horizont, duke ndarë edhe vetë qiellin, madje në disa vende ishte pothuaj e ndaluar edhe fluturimi i avionëve civilë mbi hapësirën e tyre ajrore. "Themelimi i Agjencisë Kombëtare të Trafikut Ajror (ANTA) në fillimet e viteve '90 shënoi një hap të rëndësishëm përpara, duke sjellë një faktor shumë të rëndësishëm në filozofinë e menaxhimit të hapësirës ajrore shqiptare. Forca Ajrore shqiptare si përdoruesi më i madh deri në atë kohë, e mbështetur nga NATO dhe vendet partnere, iniciuan programe të ndryshme modernizimi, trajnime të personelit dhe zhvilluan politika të reja, me qëllim implementimin e standardeve të NATO dhe ICAO", - ka theksuar gjeneralmajor Gjunksi.

Anëtarësimi i Shqipërisë në NATO në vitin 2009, ka vijuar më tej ai, shënoi sfidën e parë të rëndësishme për Forcën Ajrore shqiptare dhe ANTA. Bashkëpunimi i shkëlqyer ndërmjet Forcës Ajrore dhe ANTA, me mbështetjen e fuqishme të komponentit ajror të NATO, në Izmir dhe SHAPE, sollën suksesin që ne përjetojmë sot, policimin ajror mbi qiellin shqiptar. Por kjo ishte vetëm fillimi i një sërë angazhimesh të tjera të rëndësishme si prezenca e kontrollorëve ushtarakë në sallën operacionale të ANTA, të ulur përkrah kolegëve të tyre civilë, të trajnuar bashkërisht për çështje të shkëmbimit të informacioneve të marra nga radarët, mbështetjen e operacioneve SAR, etj. "Iniciativa e fundit, Përfaqja Rajonale Ballkanike

për Mbrojtjen Ajrore (BRAAD), është një nga programet më sfiduese, të cilin ne e mbështesim fuqimisht, të bindur se do t'i shërbejë më së miri vendeve tona. Rruga përpara është e qartë, përdorimi me zgjuarsi dhe fleksibilitet i hapësirës ajrore, shërbime më të mira, hapësira ajrore më të sigurta për përdoruesit civilë dhe ushtarakë, nën frymën e partneritetit", - ka përfunduar fjalën e tij, shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Xhemal Gjunksi.

Gjatë sesioneve plenare që u zhvilluan nga përfaqësuesit e delegacioneve zyrtare u diskutua për çështje të ngritura dhe të diskutuara në takimet e mëparshme si: për mbështetjen e misioneve, operacioneve, stërvitjeve të NATO dhe mësimet e nxjerra nga pjesëmarrja në këto misione, menaxhimin e trafikut ajror në kohë krize dhe konflikti, angazhimin e NATO për modernizimin e programit të menaxhimit të trafikut ajror, për komitetin e menaxhimit të trafikut ajror nën iniciativën "Smart Defence", etj.

Pjesëmarrësit në Takimin Plenar të Pranverës së Komitetit të NATO për Menaxhimin e Trafikut Ajror bënë vizita edhe në ambientet e Agjencisë së Trafikut Ajror në Rinas, si dhe në Komandën e Forcës Ajrore, ku vizituan Qendrën e Kontroll-Raportimit të Forcës Ajrore, e cila është ngritur dhe funksionon sipas standardeve të NATO dhe menaxhon e kontrollon trafikun ajror në Shqipëri në bashkëpunim me Qendrat e NATO dhe ANTA.

Vendimi për anulimin e takimit erdhi pas bojkotimit nga presidentët e Shqipërisë dhe Kroacisë

Mungesa e ftesës për Kosovën, anulohet takimi i Samitit të Ohrit

Presidenti i Maqedonisë, Geroge Ivanov, anuloi takimin e lartë të udhëheqësve të shteteve të nismës së Bashkëpunimit të Evropës Juglindore që ishte planifikuar të mbahej në Ohër të Maqedonisë në fund të majit. Vendimi për anulimin e takimit pasoi njoftimet, se ai do të bojkotohet nga presidentët e Shqipërisë dhe të Kroacisë, të cilët nuk janë pajtuar me mospërfshirjen e Presidentes së Kosovës, Atifete Jahjaga. Presidenti maqedonas, tha se Republika e Maqedonisë ka vepruar në përputhje të plotë me dokumentet dhe rregullat si kryesuese e përgjegjshme në këtë proces. "Për fat të keq, paragjykimet e vjetra ballkanike sërish erdhën në shprehje para mbajtjes së Samitit. Nuk do të lejojë që mbi kurrizin e Maqedonisë të thyhen këto paragjyime ballkanike. Sfidat duhet të zgjidhen me dialog jo me bojkot", tha ai në një takim me gazetarë në Shkup, duke nënvizuar se, "bashkëpunimi rajonal ndodhet para një sfide serioze".

Më herët, gjatë ditës Presidenti i Kroacisë, Ivo Josipović, anuloi pjesëmarrjen në takim. Në një njoftim të zyrës së Presidentit kroat thuhet se, qëllimi i takimeve rajonale, tubimeve rajonale është bashkëpunimi dhe përfshirja e të gjithëve nga rajoni në këtë bashkëpunim. "Kroacia mbetet e përkushtuar ndaj politikës së

bashkëpunimit rajonal, solidarizimit dhe mbështetjes së plotë për të gjitha vendet e rajonit dhe përpjekjeve të tyre për të përparuar drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian", thuhet në njoftim.

Të martën, Presidenti i Shqipërisë, Bujar Nishani, njoftoi se nuk do të marrë pjesë në takim. Shkak për këtë vendim është bërë fakti, që Presidentja e Kosovës Atifete Jahjaga nuk është ftuar të marrë pjesë, "në kundërshtim me frymën e bashkëpunimit dhe të dialogut që mbizotëron në rajon", thuhet në një njoftim të Presidencës së Shqipërisë. Presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga, nuk kishte marrë ftesë nga organizatori i Samitit në Ohër. Në një deklaratë të zëdhënësit të saj, Arbër Vllahu, thuhet se, "pjesëmarrja e Kosovës është pamundësuar për shkak të kundërshtimeve nga Serbia dhe Bosnjë Hercegovina dhe kjo bie në kundërshtim me parimin e ndërtimit të marrëdhënieve të mira fqinjësore, si parakusht i integritimeve evropiane. Përfaqësimi i Kosovës në çdo nismë rajonale dhe ndërkombe-tare bëhet mbi bazën e barabarësisë dhe është në frymën e respektimit të subjektivitetit dhe pavarësisë së secilit shtet".

Në deklaratë thuhet se, Kosova është dëshmuar si një faktor paqeje në Ballkanin Perëndimor dhe po kontribuon në qëndrueshmërinë dhe sigur-



inë e gjithë rajonit. "Ajo ka ndërtuar politika të fqinjësisë së mirë dhe të respektimit të ndërsjellë dhe përfshirja e saj në nismat rajonale do të ndihmonte në tejkalimin e dallimeve dhe pasojave të së kaluarës. Pengesat e paraqitura nga

pala e tretë për pjesëmarrjen e saj në këto nisma, janë në kundërshtim me marrëveshjen e arritur në Bruksel, me të cilën asnjëra palë nuk do të pengojë dhe as të inkurajojë dikë tjetër që të bllokojë përparimin në rrugën e integritimeve".

Kina arrin të hyjë në sistemet amerikane të armëve

Zyrtarë të Pentagonit thonë se hyrja, sipas njoftimeve, e Kinës në sistemet më të avancuara të armëve amerikane nuk ka dëmtuar aftësitë e Shteteve të Bashkuara. Të hënën gazeta "Eashington Post" njoftoi se, hakerët kinezë arritën të hynin dhe të kompromentonin dizenjot e sistemeve amerikane të mbrojtjes nga raketat si dhe të aeroplanëve dhe anijeve luftarake. Raporti sekret i Pentagonit, i cituar nga gazeta "Eashington Post", jep listën më të hollësishme të sistemeve, që thuhet se hakerët kinezë kanë arritur të hyjnë: Sistemet e mbrojtjes nga raketat, mes tyre ato Patriot, THAAD dhe sistemet mbështetëse. Aeroplanë të sofistikuar luftarakë, që janë në zhvillim e sipër si F-35

dhe Fajkuajt.

Pyetja që ngrihet tani është se si do t'i përgjigjet Uashingtoni atyre që, sipas analistëve, janë ndërhyrje kibernetike të Pekinit. Në fjalimin mbi gjendjen e vendit, që mbajti në muajin shkurt, Presidenti Obama foli rreth kësaj çështjeje. "Ne e dimë se, vende dhe kompani të huaja dëmtojnë sekretet tona. Tani, armiqtë tanë përpiqen gjithashtu të sabotojnë centralet tona energjitike, institucionet tona financiare dhe sistemet tona të kontrollit ajror. Ne nuk mund të lejojmë që të kalojnë vite dhe të shkojmë nga e kaluara dhe të pyesim veten se pse nuk bëmë asgjë, kur përballëshim me kërcënime reale ndaj sigurisë dhe ekonomisë tonë".

Ky kërcënim është shtu-

ar, ndërsa Kina modernizon ushtrinë dhe përpiket të gjejë mënyra për të zhvilluar sistemet e veta të armëve. Jason Healey është specialist i sigurisë kibernetike në Këshillin e Atlantikut, një organizatë kërkimesh në Uashington. "Ne e dimë se gjatë viteve të fundit, kinezët i kanë zgjeruar ndjeshëm programet e tyre të mbrojtjes. Dhe kjo përputhet plotësisht me zhvillimet, që kemi parë në fusha të tjera të sistemeve ushtarake të Kinës".

Në takimet e tyre me zyrtarë kinezë, zyrtarët amerikanë kanë ngritur për vite me radhë çështjen e sulmeve kibernetike, por qeveria amerikane vetëm kohët e fundit ka filluar t'i bëjë më publike ankesat e

saj. "Para 6 muajsh, Shtetet e Bashkuara ende nuk kishin një qëndrim se si të vepronin ndaj këtij aspekti. Tani qeveria amerikane, nga Presidenti deri tek zyrtarët e niveleve më të ulëta, kanë deklaruar se Kina do të konfrontohet kryesisht në takime private, por edhe në publik lidhur me këtë çështje". Pentagoni thotë, se e shikon me shumë seriozitet kërcënimin e spiunazhit kibernetik, madje ka ndërmarë masa për të mbrojtur aftësitë e veta. Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Chuck Hagel, do të ketë mundësinë që ta ngrejë këtë çështje me zyrtarët kinezë të mbrojtjes, kur të marrë pjesë në takimin e nivelit të lartë, mbi sigurinë të vendeve aziatike, që do të mbahej këto ditë në Singapor.



Imami dekoron dy ekspertë amerikan

Në Ministrinë e Mbrojtjes është organizuar më 24 maj 2013një ceremoni e veçantë me rastin e dekorimit me medaljen "Për Shërbime të Shquara" të z. Robin Sakoda dhe z. Jaan Muruets, dy ekspertë amerikan që kanë kontribuar në procesin e hartimit të Dokumentit të Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes. Në këtë ceremoni ishin të pranishëm ministri i Mbrojtjes, z. Arben Imami, zëvendësministri i Mbrojtjes, z. Arian Starova dhe znj. Arta Musaraj, zëvendës shefat e Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Viktor Bërdo dhe gjeneral brigade, Sandër Lleshi, gjeneralë, drejtorë dhe ushtarakë të tjerë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të FA.

Medalja "Për Shërbime të Shquara" u është akorduar dy ekspertëve amerikan nga ministri i Mbrojtjes me këtë motivacion: "Për angazhimin profesional të treguar, për vlera të veçanta, si dhe kontribut të paçmuar në procesin e Rishikimit të Strategjisë së Mbrojtjes".

Ministri i Mbrojtjes Imami, duke marrë fjalën në këtë ceremoni theksoi se, është kënaqësi e madhe për mua sot që në emër të Ministrisë së Mbrojtjes të jap medaljen "Për Shërbime të Shquara" z. Robin Sakoda dhe Jaan Murumets. Procesi i Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes, ka qenë një nga arritjet më të mëdha të Forcave tona të Armatosura, të Ministrisë së Mbrojtjes dhe përgjithësisht të komunitetit të sigurisë në këtë vend, dhe u përfshinë të gjitha kapacitetet më të mira të FA dhe Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe të institucioneve të tjera që kontribuojnë në fushën e sigurisë në Shqipëri, - nënvizoi z. Imami, - por duke qenë se ky proces kërkonte kapacitetet më të mira dhe të angazhuara në këtë punë, mbas Samitit të Lisbonës i kërkova Departamentit të Mbrojtjes së SHBA, ndihmë dhe këshillim për këtë proces, ndihma e të cilëve na u dha menjëherë. "Jam i sigurt që ky proces nuk do të ishte bërë i mundur dhe nuk do të kishte arritur këtë sukses të madh pa ndihmën e ekspertëve amerikanë, përkatësisht z. Sakoda. dhe z. Murumets. Pavarësisht se z. Sakoda thotë që ky proces ishte tërësisht shqiptarë, këshillat e ekspertëve amerikanë ishin shumë të vlefshme. Mirënjohja jonë dhe falënderimet e mia janë sepse ju nuk mbështetët thjeshtë një dokument, por një proces, i cili rriti kapacitetet tona". - ka përfunduar, ministri Imami.

Të dy ekspertët amerikanë, z. Robin Sakoda dhe Jaan Muremets, duke marrë fjalën pas dekorimit, shprehën falënderimet e tyre për vlerësimin që iu bë nga ministri i Mbrojtjes, duke theksuar se në Shqipëri ata gjetën miq të vërtetë dhe kolegë të mirë gjatë gjithë periudhës së qëndrimit të tyre vendin tonë.